



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" SH.A

Komuna e Drenasit

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur në Prishtinë me datë 12/09/2025, ndërmjet :

Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A., rr."Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Arsim Fetahu (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Komunës së Drenasit, përfaqësuar nga z.Ramiz Lladrovci, kryetar i Komunës së Drenasit (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar me synimin për të krijuar një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet palëve të përfshira, me qëllimin e përbashkët të financimit dhe realizimit të projektit të specifikuar në këtë dokument. Në këtë kontekst, palët angazhohen të kontribuojnë me burimet e tyre financiare, teknike dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e suksesshëm të këtij projekti, duke ndarë përgjegjësitë dhe përfitimet që rrjedhin nga to.

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është financimi i përbashkët i këtij Projekti:

1. Ndërtimi i kapacitetit të ujësjiellësit në Komunën e Drenasit me vlerë 79.858.00 €. Nga shuma totale e kësaj kontrate që parashikohet të përfundojë brenda vitit 2025, KRU Prishtina SH.A. do të financojë me shumën prej 50.000.00 €, ndërsa Komuna e Drenasit do të participojë me vlerën prej 29.858.00 €.

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim të participojë - bashkefinancojë për projektin e përmendur në nenin 1 të paragrafit 1.

2. Shuma e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, do të ndahet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Drenasit.

Neni 3

Obligimet e Kompanisë

1. Kompania do të hartojë projektin detal dhe i njëjti do të aprovohet nga subjektet e këtij Memorandumi.
2. Kompania ndanë mjetet financiare nga buxheti i saj sipas nenit 1 të paragrafit 1.
3. Pas pranimi teknik, Kompania obligohet t'i regjistrojë konsumatorët - përfituesit të projektit dhe të funksionalizojë projektin në tërësi, i cili mbetet pronë e Kompanisë.

Neni 4

Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Komuna e Drenasit, e cila do të përzgjedhë Kontraktin, ndërsa në procesin e përzgjedhjes do të jetë një zyrtar nga Kompania.
2. Disbursimi i mjeteve nga të dyja palët e Memorandumit do të realizohen pas pranimi të raportit përfundimtar të punimeve nga Menaxheri i Kontratës.
3. Bajtjen e mjeteve Kompania e bën në xhirillogarinë e Komunës, pasi të përfundojnë procedurat e pranimi teknik dhe raportet përkatëse, sipas vlerës së faturës/faturave.

Neni 5

Mbikëqyrja e punimeve

1. Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Memorandumi, ku secili do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve.
2. Komuna do të përfshijë në Komisionin e Pranimi Teknik një zyrtar nga Kompania.

Neni 6

Vlerësimi i zbatimit të Memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkarisht zbatimin e memorandumit përmes hartimit dhe paraqitjes së një Raporti periodic me shkrim.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurin e zhvillimeve të aktiviteteve të kryerjes së punëve ndërtimore dhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.



Neni 7
Komunikimi ndërmjet palve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe të shkëmbejnë cdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të bëhet në formë elektronike. Në cdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 3 ditëve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshëm dhe në cdo kohë për komunikim dhe kordimin me njëri tjetrin me qëllim të dakordimit të veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 8
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mund të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Memorandumi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Arsim Fetahu

z. Ramiz Lladrovci

Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Prishtina" sh.a

Kryetar i Komunës së Drenasit

